



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion

Znj. _____

Në vijim të kërkesës suaj për informacion ju informojmë si më poshtë:

1. A ka bashkia programe për parandalimin e dhunës ndaj grave e vajzave në familje?

Bashkia e Shkodrës, gjatë viteve të fundit i ka kushtuar rëndësi të vecantë çështjeve gjinore dhe dhunës në familje, duke i integruar në të gjitha programet dhe funksionet e saj.

Disa nga aktivitetet dhe arritjet në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje që mund të përmendim janë:

Bashkia e Shkodrës ka krijuar dhe vënë në funksion Qendrat Komunitare “Për Familjen”; Aktualisht janë në funksion 12 qendra; 7 në zonën urbane dhe 5 në njësitë administrative. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës që nga viti 2015 është krijuar dhe vënë në funksion strehëza për rastet emergjente të dhunës me bazë gjinore.

Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar Kartën Evropiane në 8 Mars 2017, duke e bërë atë pjesë të dokumentave dhe instrumentave që orientojnë veprimet dhe hapat që ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Menjëherë pas marrjes së këtij

angazhimi publik, i gjithë stafi i Bashkisë Shkodër është angazhuar maksimalisht për zbatimin në praktikë të Kartës Evropiane.

Përveç përkushtimit për hartimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020 për një periudhë relativisht të shkurtër kohore, Bashkia Shkodër caktoi në buxhetin e saj vjetor një zë dhe fonde përkatëse pikërisht për aktivitete për zbatimin e Kartës Evropiane.

Gjatë vitit 2018, si hap i parë i zbatimit në praktikë të Kartës Evropiane për Barazi të burrave dhe grave në jetën vendore Bashkia e Shkodrës ka përgatitur dhe miratuar planin e veprimit për Barazinë Gjinore. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore, mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë: respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve; trajtimin e çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e stereotipeve gjinore; pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendim-marrjen politike e publike; aksesin në shërbime të ndryshme të hartuara sipas nevojave të veçanta të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë; integrimin e këndvështrimit gjinor në të gjitha planet dhe fushat për zhvillim të qëndrueshëm; planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Buxhetimi me pjesëmarrje – konsultimi i buxhetit të bashkisë për çdo program buxhetor; zhvillimi ekonomik, turizmi, investimet, shërbimet publike, shërbimet sociale, etj., me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin dhe palë të interesuara.

Buxhetimi gjinor – proces që krijon një perspektivë gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim promovimin e barazisë gjinore.

Bashkia e Shkodrës ka realizuar dëgjesa publike në njësitë administrative zonën urbane dhe rurale ku pjesëmarrëse në këto takime kanë qenë gra dhe burra, të cilët kanë diskutuar mbi nevojat e tyre në territor.

Hapja e çerdheve, kopshteve dhe qendrave shëndetësore të reja, në shërbim të komunitetit me qëllim krijimin e mundësive për punësim të grave dhe vajzave – nëna.

Krijimi i apartamenteve sociale (ish-konvikti pyjores) me destinacion jetimët që jetojnë në konvikte, jetimët që dalin nga strukturat rezidenciale dhe gratë kryefamiljare në situatë të vështirë socio-ekonomike.

Planifikimi i shërbimeve publike, është realizuar sipas qasjes gjinore; shërbime dhe investime që i përgjigjen njëloj të dyja gjinive; mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, prodhimi,

trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm, shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike duke ndikuar kështu drejt për drejtë në sigurinë e vajzave dhe grave, banore në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Të gjitha aktivitetet sensibilizuese që organizohen nga Bashkia e Shkodrës, në ditë ndërkombëtare (8 marsi-dita ndërkombëtare e gruas, 8 prilli-dita ndërkombëtare e romëve, 15 maj-dita ndërkombëtare e familjes, 1 qershor-dita kombëtare e fëmijëve, 1 tetor-dita e të moshuarve, 20 nëntor-dita ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 25 nëntor-10 dhjetor - 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, etj.) i kushtojnë vëmendje të veçantë qasjes gjinore dhe promovimit të rolit të gruas në shoqëri. Në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, Bashkia e Shkodrës planifikon dhe zhvillon një sërë aktivitesh sensibilizuese. Aktivitetet zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e shoqërisë civile, institucionet publike dhe sigurisht median, me synim shpërndarjen e informacionit sa më gjerë. Organizime të veprimtarive ndërgjegjësuese, si; aktivitete me të rinjtë, forume diskutimi, takime me grupe vulnerabel ndaj fenomenit dhunë në familje, emisione në media, etj., zhvillohen përgjatë të gjithë vitit, por theksi dhe intensiteti i tyre është në 16 ditët e aktivizmit.

Bashkia e Shkodrës ka një traditë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e saj është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në vazhden e traditës së mirë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile Bashkia Shkodër ka bashkëpunuar ngushtë edhe me organizatat ndërkombëtare të tilla si: UNDP DHE UN WOMEN, si dhe organizata të tjera si: organizata Gruaja te Gruaja, Terre Des Hommes Albania, Hapat e Lehtë, Albanian Disability Rights Foundation, Papa Giovanni XXIII, World Vision, Nisma për ndryshim shoqëror, Hope for the Earth, Gender Alliance for Development Center për çështjet e dhunës me bazë gjinore.

Në territorin e bashkisë së Shkodrës, pas zgjedhjeve vendore të 2015, përfaqësimi i grave në politikë e vendimmarrje ka pësuar një përmirësim të dukshëm; Bashkia e Shkodrës dhe Këshilli Bashkiak drejtohet nga një grua. Një ndër Nënkryetaret e Bashkisë Shkodër është grua. Këshilli Bashkiak ka 51 anëtarë nga të cilët 25 gra. Stafi i Bashkisë Shkodër - 55.1% janë gra dhe 44.9% janë meshkuj.

Një eksperiencë e tillë, është absolutisht një sfidë, por edhe një motiv pozitiv për të shfaqur qartë mundësitë e femrave në politikë dhe vendimmarrje.

Bazuar në sa mësipër, mund të themi se sot ka një përpjekje të vetdijshme nga Bashkia Shkodër, që të përvetësojmë qasje të reja në fusha të ndryshme si administratë, investime, procese politike

dhe jetë publike në mënyrë që të fillojmë një ndryshim strukturor, që përkthehet në implementim konkret të objektivave të barazisë gjinore në nivel qeverie vendore.

2. Çfarë shërbimesh mbështetëse u ofrohet personave të dhunuar?

Për çdo rast të personave të dhunuar ofrohen shërbime parashoqërore (informimi, orientimi, këshillimi, shërbime në familje, mbështetje psiko-sociale dhe ndërhyrje të hershme); shërbime komunitare (mbrojtja e fëmijëve, shërbime për fëmijën dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, shërbime arsimore, lëvizëse, shërbime për higjenën personale, kujdesin shëndetësor); shërbime të strehimit emergjent dhe të përkohshme (strehëz për situatë emergjente dhe banesa sociale). Në varësi të nevojave specifike të rastit, ofrohen edhe shërbimet specifike për të cilat individi ka nevojë.

3. A ofrohet trajtim/këshillim/ndihmë e specializuar psikologjike për personat e dhunuar?

Në Bashkinë e Shkodrës çdo rast që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, është trajtuar në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës dhe në bashkëpunim me institucionet / OSHC-të pjesë të MKR-së. Në varësi të problematikave të konstatuara, ofrohet trajtim, këshillim dhe ndihmë e specializuar për personat e dhunuar.

4. Sa është numri i koordinatorëve për referimin e dhunës në familje në të gjithë bashkinë tuaj, pra sa koordinatorë të tillë ka një njësi administrative dhe a e përballon dot fluksin e punës?

Pozicioni i koordinatorit vendor të mekanizmit të referimit për rastet e dhunës me bazë gjinore është vend vakant aktualisht. Puna mbulohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe Qendrat Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër.

Pozicioni i Koordinatorit vendor të dhunës në Bashkinë Shkodër është hapur që në vitin 2009. Aktualisht pozicioni është vend vakant, pasi nuk ka pasur konkurentë të kualifikuar në shpalljen e realizuar. Do të bëhet përsëri shpallja për vendin vakant për pozicionin e Koordinatorit vendor të mekanizmit të referimit për rastet e dhunës me bazë gjinore.

5. Si paraqitet bashkëpunimi mes bashkisë, policisë dhe gjykatave në rastet e dhunës në familje?

Bashkëpunimi midis Bashkisë së Shkodrës, Policisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i mirë.

6. Sa raste ka bashkia kur gruaja me urdhër mbrojtjeje, lihet të qëndrojë në të njëjtën banesë me burrin që e dhunon në pamundësi për ta levizur?

Në të gjitha rastet kur viktimat me UMM ose UM është vlerësuar si rast me nivel rrisht të lartë, është realizuar ndërhyrja për strehimin e tyre në strehëzën e emergjencës së Bashkisë Shkodër dhe pas kalimit të gjendjes së emergjencës strehimi në strehëza të tjera afatgjata, ose sipas nevojave është siguruar pagesa e një shtëpie me qera, në sajë të bashkëpunimit shumë të mirë me organizatat e shoqërisë civile, duke punuar dhe për riintegrimin e tyre në vazhdimësi.

7. Si ndiqen raste të tilla?

Të gjitha rastet trajtohen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie në bashkëpunim të ngushtë me disa nga aktorët kryesorë të MKR-së si: Policia Vendore e Policisë Shkodër, organizatat e shoqërisë civile (Gruaja tek gruaja, Shpresë për Botën etj.), Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër dhe NJVKSH Shkodër, në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës. Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”(i ndryshuar) , i ndryshuar me Ligjin Nr.47/2018, neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2017, ka koordinuar dhe nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për riorganizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga të gjitha institucionet publike që veprojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës me rastet e dhunës në familje dhe gjithashtu organizatat e shoqërisë civile që janë aktive dhe veprojnë në territor me këtë target grup. Bashkëpunimi midis këtyre institucioneve dhe organizatave ka qenë i mirë. Aktorët i janë përgjigjur në kohë nevojës për veprim dhe menaxhim të rasteve.

ETN mblidhet ad-hoc, në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve ose brenda javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mblidhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin. (psh; policia, organizata, Bashkia, qendrat komunitare). Në momentin që paraqitet një rast dhune, bëhet vlerësimi fillestar për të parë nivelin e rrishtit në të cilin ndodhet viktimat. Më pas bëhet vlerësimi i detajuar, sipas nevojave që paraqet rasti, mblidhet ETN, ndahen rolet e përgjegjësitë. Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në rast se këto institucione nuk i ofrojnë, kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë. Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe

Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

8. A ka bashkia strehëza /shtëpi të sigurta për viktimat e dhunës të cilëve gjykata u ka dhënë urdhër mbrojtjeje? Sa strehëza të tilla ka në territorin e bashkisë suaj dhe a janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat?

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës që nga viti 2015 është krijuar dhe vënë në funksion strehëza për rastet emergjente të dhunës me bazë gjinore. Strehëza menaxhohet në bashkëpunim me organizatën Gruaja tek Gruaja dhe NISMA për Ndryshim shoqëror. Në Shkodër, gjithashtu ndodhet edhe strehëza afatgjatë e trajtimit të rasteve të dhunës në familje e organizatës Papa Giovanni XXIII.

9. A ofron bashkia trajtim/këshillim/ndihmë e specializuar psikologjike për burra/djem dhunues?

Në Bashkinë e Shkodrës funksionon “Zyra për Djem dhe Burra”, e cila ofron programe këshillimi, konsulence dhe rehabilitimi për dhunuesit. Përgjatë këtyre viteve ata kanë vazhduar ofrimin e shërbimeve të tyre nëpërmjet këshillimit psikologjik për dhunuesit, si dhe programet/aktivitetet e tyre me të rinjtë, komunitetin, partner të tjerë për të ofruar ndihmën e tyre në integrimin e shërbimit për trajtimin e dhunuesve në MKR-në Shkodër.

Vlen për t’u theksuar edhe gjendja e jashtëzakonshme që kemi kaluar, e shkaktuar nga pandemia COVID-19, gjatë së cilës problematikat e dhunës në familje u shtuan edhe më shumë. Shembull i mirë i vazhdimin të ofrimit të shërbimeve ka qenë edhe këshillimi online/telefonik, si dhe hartimi i një manuali, të shkurtër dhe praktik, për t’iu ardhur në ndihmë, në veçanti të gjithë djemve dhe burrave që ndiheshin të pasigurt ndërkohë që ndodheshin në karantinim.

10. A ka programe/mundësi edukimi nga institucione të tjera për burrat dhunues?

Përgjatë të gjithë vitit Bashkia Shkodër organizon aktivitete sensibilizuese me një theks të veçantë sensibilizimin e të rinjve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, duke punuar fort veçanërisht me djemtë. Të gjitha aktivitetet sensibilizuese që organizohen nga Bashkia e Shkodrës, në ditë ndërkombëtare (8 marsi-dita ndërkombëtare e gruas, 8 prilli-dita ndërkombëtare e romëve, 15 maj-dita ndërkombëtare e familjes, 1 qershor-dita kombëtare e fëmijëve, 1 tetor-dita e të moshuarve, 20 nëntor-dita ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 25 nëntor-10 dhjetor - 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, etj.) i kushtojnë vëmendje të veçantë qasjes gjinore dhe promovimit të rolit të gruas në shoqëri. Në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, Bashkia e Shkodrës planifikon dhe zhvillon një sërë aktivitetesh sensibilizuese. Aktivitetet zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e

shoqërisë civile, institucionet publike dhe sigurisht median, me synim shpërndarjen e informacionit sa më gjerë. Organizime të veprimtarive ndërgjegjësuese, si; aktivitete me të rinjtë, forume diskutimi, takime me grupe vulnerabël ndaj fenomenit dhunë në familje, emisione në media, etj., zhvillohen përgjatë të gjithë vitit, por theksi dhe intensiteti i tyre është në 16 ditët e aktivizimit.

11. A ofron bashkia linjë këshillimi falas 24 orë për rastet e dhunës?

Në bashkëpunim me organizatat partnere të tilla si: Alo 116111, Gruaja tek gruaja apo Linja Kombëtare e Këshillimit për gra e Vajza, në të gjitha aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese promovohet shërbimi i ofrimit të këshillimit falas.

12. A u ofrohet personave të dhunuar ndihmë ligjore falas nga bashkia?

Të gjitha rastet e dhunës përfitojnë në varësi të nevojave edhe shërbimet përkatëse në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile si: Gruaja tek Gruaja, Hapat e Lehtë, Qendra për Nisma Ligjore etj.

13. Ka bashkia në dispozicion jurist dhe psikolog për të ndjekur rastet e dhunës?

Bashkia Shkodër, konkretisht Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen” kanë në organigramën e saj specialistë, me profesione juristi dhe psikologu të cilët në varësi të nevojave ndjekin edhe rastet e dhunës në familje në seancat gjyqësore.

14. A orientohen personat e dhunuar në tregun e punës?

Çdo rast dhune , kur është e nevojshme referohet ne tregun e punës përmes referimit në Zyrën e Punësimit.

15. Cilat janë burimet e financimit të bashkisë (të vete bashkisë ose nga pushteti qëndror) për shërbime ndaj viktimave të dhunës?

Fondi në dispozicion për ofrimin e shërbimeve konsiston në kostot për paga dhe sigurime për stafin (2,526 mijë lekë) dhe kosto operative (486 mijë lekë) për funksionimin e qendrave komunitare “Për Familjen”, të cilat menaxhojnë drejtpërdrejtë rastet e dhunës në familje. Fondet janë fonde nga të ardhurat e vetë Bashkisë Shkodër.

Buxheti në dispozicion të aktiviteteve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore, për vitin 2020 ka qënë i ndarë në këto zëra:

1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (200 mijë lekë).
2. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore. (200 mijë lekë).
3. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi (150 mijë lekë).

16. Sa është përqindja e buxhetit që Ministria e Financave i jep bashkisë për të ofruar shërbime ndaj viktimave të dhunës?

Nuk ka financime nga Ministria e Financave për ofrimin e shërbimeve ndaj viktimave të dhunës.

17. Cilat janë nevojat e Bashkisë për të përmirësuar më shumë punën në parandalimin e dhunës në familje?

Problematikat dhe sfidat janë të shumta sepse çdo rast i dhunës në marrëdhëniet familjare është unik dhe specifik, duke evidentuar nevoja dhe problematika të ndryshme nga rasti në rast.

Disa nga sfidat dhe nevojat kryesore më të cilat hasemi në punën tonë të përditshme dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje janë:

- Bashkëpunimi ndërinstucional në disa raste dhe marrja e përgjegjësive sipas legjislacionit në fuqi nga secili prej anëtarëve të MKR-së.
- Fuqizimi socio-ekonomik dhe riintegrimi në shoqëri i viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare të çdo forme qofshin ato.
- Kapacitetet e kufizuara njerëzore, infrastrukturore, burimet financiare të limituara dhe të munguara në shumicën e rasteve.
- Strehimi afatgjatë i viktimave të dhunës në familje dhe kapacitetet e kufizuara të strehimit emergjent.
- Ngritja, financimi dhe qëndrueshmëria e shërbimeve komunitare në zonat rurale, që përbëjnë edhe shumicën e njësive administrative në territorin e bashkisë së Shkodrës mbetet vështirësia më e madhe për shërbime cilësore e të qëndrueshme. Megjithë detyrimin ligjor të kontributit qeveritar për financimin e shërbimeve sociale në përgjithësi dhe të shërbimeve direkte për administrimin e mbrojtjes e të integritit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, deri tani këto shërbime realizohen dhe financohen vetem me financimin e Bashkisë Shkodër dhe të donatorëve e OJQ. Për rrjedhojë financimi e qëndrueshmëria e shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në nivel vendor mbetet sfida më e rëndësishme në implementimin e SKBGJ.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Voltana Ademi